Fjala e Ambasadorit Michel Tarran, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Fjalë Përshëndetëse e Kryetarit të Prezencës
Nga politikat arsimore te mësimdhënia e historisë së diktaturës komuniste:
Arritjet, sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ndërinstitucional

Tiranë, 24 nëntor 2026 – 10:00
Vendndodhja: Hotel Rogner, Salla Antigonea 2

E nderuar znj. Sula,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve, profesorë, kolegë dhe partnerë,

- Kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen në tryezën e sotme të diskutimit, të organizuar bashkërisht nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Dëshiroj të falënderoj të gjitha institucionet pjesëmarrëse, përfaqësuesit e botës akademike, historianët, mësuesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për pjesëmarrjen në këtë diskutim të rëndësishëm.
- Arsimi luan një rol thelbësor në procesin e drejtësisë tranzitore. Trajtimi i së kaluarës nuk duhet të kufizohet vetëm në dokumentimin e ngjarjeve historike dhe njohjen e viktimave. Ai duhet gjithashtu t'i ndihmojë brezat e ardhshëm të kuptojnë pasojat e diktaturës dhe rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike.
- Ndaj, mësimdhënia mbi të kaluarën komuniste të Shqipërisë nuk ka të bëjë thjesht me kthimin e vështrimit pas në histori. Ajo synon t'u japë të rinjve njohuri dhe aftësi të mendimit kritik, të nevojshme për të kuptuar historinë dhe për të vlerësuar rëndësinë e demokracisë.
- Edukimi historik duhet të jetë i saktë dhe gjithëpërfshirës. Nxënësit duhet të kenë në dispozicion informacion të besueshëm mbi diktaturën komuniste, përfshirë shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe pasojat e tyre për individët dhe shoqërinë. Dokumentet arkivore, kërkimet historike dhe dëshmitë e viktimave dhe të mbijetuarve mund ta bëjnë këtë pjesë të historisë më konkrete dhe më kuptimplotë.
- Po aq e rëndësishme është që mësuesit të mbështeten me njohuritë, materialet edukative dhe mjetet metodologjike të nevojshme për trajtimin e kësaj periudhe të ndjeshme në orët mësimore. Edhe qasjet novatore, përfshirë burimet digjitale, historinë gojore dhe vizitat në vendet e kujtesës, mund të ndihmojnë në përfshirjen e brezave të rinj.
- Shqipëria ka institucione të specializuara, arkiva, qendra kërkimore dhe muze, të cilat kanë ekspertizë dhe dokumentacion të vlefshëm mbi të kaluarën komuniste. Sfida qëndron në ndërthurjen më sistematike të këtyre burimeve me sistemin arsimor, duke siguruar që ato të jenë në dispozicion dhe të dobishme për mësuesit dhe nxënësit.
- Kjo kërkon një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), universiteteve, institucioneve të kujtesës, historianëve dhe mësuesve. Një bashkëpunim i tillë mund të ndihmojë në kalimin nga nismat individuale drejt një qasjeje më të koordinuar për mësimdhënien e kësaj pjese të rëndësishme të historisë së Shqipërisë.
- Prezenca e OSBE-së mbetet e angazhuar për mbështetjen e drejtësisë tranzitore, kujtesës historike dhe edukimit për të drejtat e njeriut në Shqipëri. Ne e konsiderojmë tryezën e sotme si një mundësi për të identifikuar mangësitë ekzistuese, për të kuptuar më mirë nevojat institucionale dhe për të hartuar rekomandime konkrete për bashkëpunimin e ardhshëm.
- Mënyra se si e mësojmë historinë pasqyron vlerat që dëshirojmë t'u përcjellim brezave të ardhshëm. Sepse, të kuptuarit e të kaluarës së Shqipërisë nga të rinjtë nuk është thjesht çështje e ndërgjegjësimit historik, por edhe një investim për respektimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike.
- Ju uroj diskutime të frytshme dhe pres me interes rezultatet e tryezës së sotme!

Ju faleminderit!